

STATUTI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
NJOMË SH.P.K.

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
- QKB” – Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

KREU I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Më datë 03.10.2024 unë i nënshkruari: Arben GEGA, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit I90926001C; do të regjistroj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **NJOMË SH.P.K.**

Neni 2
Objekti

Fusha e veprimtarisë do të jetë tregti me shumicë dhe pakicë, produkte bulmeti, produkte mishi, produkte peshku. Import, eksport, grumbullim dhe tregëtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe blegtoralë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresen: Rr. Nikolla Tupe; Pasuria me nr. 3/110+1-N3, Vol 81, Fq 136, Zona Kadastrale 8270, Tiranë, kod postar 1000.



KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) lekë të ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100 lekë për kuotë e cila zotërohet nga ortaku i vetëm Arben GEGA.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet Vendimarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërine për çeshtjet e mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;



- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblene e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të parë të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, pavarësisht parregullësisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çeshtje të tjera si :

- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëme, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Z. Arben GEGA është Administrator i kësaj shoqërie

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKB;
- e) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Në mënyrë të veçante, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividende;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16 **Viti Financiar**

16.1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, nëse kompania plotëson kushtet ose për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i

detyruar që t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shënuar nëçdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper“.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes së Pergjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

NJOMË SH.P.K.

Arben GEGA

Arben Gega

